

<b>Emri i projektit:</b>	Shërbimet rehabilituese multidisiplinare të cilësisë së lartë për fëmijët me aftësi të kufizuar.
<b>Kohëzgjatja:</b>	15.03.2022 – 31.10.2022
<b>Shtrirja gjeografike:</b>	Ferizaj
<b>Buxheti total i grantit (EUR):</b>	17.000.00€
<b>Objektivat:</b>	<p>Mbështetja e fëmijëve me aftësi të kufizuar që të zhvillojnë aftësitë e tyre, praktikojnë pavarësinë dhe të mundësohet përfshirja e tyre në shkollë dhe jetën në komunitet, përmes ofrimit të shërbimeve rehabilituese multidisiplinare me bazë në komunitet të cilësisë së lartë.</p> <p>Mbështetja e familjeve për të tejkaluar vështirësitë dhe aftësimin e tyre për të përkrahur zhvillimin fizik, shoqëror dhe arsimor dhe për të avokuar për të drejtat e fëmijëve të tyre.</p> <p>Rritja e kapaciteteve të palëve të interesit në identifikimin e nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, të përgjigjen/adresojnë këto nevoja dhe monitorojnë progresin si dhe përfshirjen e tyre në ngjarje dhe fushata promovuese për të drejtat e fëmijëve për të ndikuar në ndryshimin e qëndrimeve publike.</p>
<b>Grupet e synuara:</b>	<p>Grupet e synuara janë fëmijë me aftësi të kufizuar (djem dhe vajza) të grup-moshës + 14 vjeç dhe familjet e tyre.</p> <p>Gjithsej 30 fëmijë dhe prindërit e 30 fëmijëve do të përfitojnë nga shërbimet e integruara. Fëmijët janë identifikuar përmes databazës së plotësuar nga Handikos Ferizaj ndër vite, përmes bashkëpunimit me Qendrën e Mjekësisë Familjare, Qendrën për Punë Sociale, DKA dhe partnerëve tjerë lokal. Pasi që Qendra e ka mundësinë të iu shërbejë një numri të kufizuar të personave, prioritet do të kene nën-grupet më të ndjeshme të popullsisë së fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe do të përzgjedhen në bashkëpunim me DKA</p>
<b>Përmbledhje e grantit:</b>	<p>Projekti synon ofrimin e shërbimeve rehabilituese multidisiplinare për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre me qëllim që fëmijët me aftësi të kufizuara të zhvillojnë aftësitë e tyre, praktikojnë pavarësinë dhe të mundësohet përfshirja e tyre në shkollë dhe jetën në komunitet, të mbështetë familjet në aftësimin e tyre, për të tejkaluar vështirësitë dhe për të përkrahur zhvillimin fizik, shoqëror dhe arsimor të fëmijëve të tyre si dhe për të avokuar për të drejtat e fëmijëve të tyre. Projekti gjithashtu synon të kontribuon në rritjen e kapaciteteve të palëve të interesit në identifikimin e nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, të përgjigjen/adresojnë këto nevoja dhe monitorojnë progresin si dhe përfshirjen e tyre në ngjarje dhe fushata promovuese për të drejtat e fëmijëve për të ndikuar në ndryshimin e qëndrimeve publike.</p>
<b>Donatori:</b>	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.